



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2021  
EKSTRAKT

### V E N D I M

**Nr. 372, Datë 17.11.2021**

#### **PËR CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ PROKURORES**

**ZNJ/Z.\*\*\*\*\* \*\*\*\*\***

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në Ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i ndryshuar; nenet 184 germa "e", neni 189 pika 1, germa "a", neni 192 paragrafi 1 fjalia e dytë, të Ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar; nenin 104 të Ligjit nr.44/2015, Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", pasi shqyrtoi kërkesën për procedim disiplinor që i përket;

#### **KËRKUES:**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani

**SUBJEKTI I PROCEDIMIT:** Znj/Z. \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\*

#### **OBJEKTI:**

Fillimi i Procedimit Disiplinor ndaj magjistrates \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* , me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës  
së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\*

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi zhvilloi seancën dëgjimore, shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e neneve 142 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe dëgjoi:

- Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates \*\*\*\*\* me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\* për shkeljet disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “d”, e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe caktimin ndaj saj të masës disiplinore “Vërejtje publike”.

- Magjistrate \*\*\*\*\* e cila përfundimisht e kundërshton kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor ndaj saj, me pretendimin se, faktet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është administruar kërkesa me Nr.\*\*\*\*\* prot., datë \*\*.\*\*.20\*\*, “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates \*\*\*\*\* me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\*”, ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, shoqëruar me Raportin e Hetimit Disiplinor nr.\*\*\*\*\* prot., datë \*\*.\*\*.20\*\* “Për hetimin disiplinor të magjistrates \*\*\*\*\*”, së bashku me dosjen hetimore.

Shkak për fillimin e këtij hetimi disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë bërë informacionet e përcjella nga media në lidhje me një ngjarje të ndodhur në qytetin e \*\*\*\*\*.

Nisur nga informacioni i përcjellë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me Vendimin nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_\_\_, ka vendosur verifikimin e të dhënave të rastit që lidhen me veprimtarinë e prokurorit \*\*\*\*\* i cili kishte hetuar procedimin penal të filluar lidhur me ngjarjen e referuar.

Në përfundim të verifikimit të rastit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me Vendimin nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë, ndaj prokurores \*\*\*\*\*.

Në lidhje me sjelljen e prokurores \*\*\*\*\* Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në përfundim të hetimit disiplinor, me Vendimin nr.\*\*\*\*\* prot., datë \*\*.\*\*.20\*\*, ka vendosur:

- Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit/es \*\*\*\*\* me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\* për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, germa “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Propozimin e masës disiplinore “*Vërejtje publike*”, të parashikuar nga neni 107, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, germa “d”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në vijim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 138, pika 1, e Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, me shkresën nr.\*\*\*\*\* prot., datë \*\*.\*\*.20\*\*, ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates \*\*\*\*\*”, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\*”, bashkëlidhur Raportin e Hetimit dhe dosjen hetimore, për arsye të zhvillimit të procedurës disiplinore nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në ngarkim të magjistrates \*\*\*\*\*.

Hetimi disiplinor i kryer nga ILD, lidhet me procedimin penal nr.\*\*\*\*, datë \*\*.\*\*.\*\*\*\*, regjistruar për një ngjarje të ndodhur në qytetin e \*\*\*\*\*, në fshatin \*\*\*\*\* , ku me datë \*\*.\*\*.20\*\*, ka ndërruar jetë viktimia \*\*\*\*\*. Policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë \*\*\*\*\* , ka referuar çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, \*\*\*\*\* , për kryerjen e veprës penale “\*\*\*\*\*” ku është regjistruar materiali kallëzues nr.\*\*\*\*\* , datë \*\*.\*\*.\*\*\*\*. Me ndjekjen penale lidhur me këtë kallëzim penal, me short është caktuar prokuror/e e kësaj prokurorie Znj/Z. \*\*\*\*\* e cila në përfundim të verifikimeve me vendimin e datës \*\*.\*\*.\*\*\*\* ka vendosur *mosfillimin e procedimit penal* me arsyetimin se fakti nuk përmban elementët e veprës penale. Shtetase \*\*\*\*\* ka paraqitur ankim kundër vendimit të prokurorit për *mosfillimin e procedimit penal*.

Gjykata e Rrethit, \*\*\*\*\* , me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.\*\*.20\*\* ka vendosur pranimin e ankimit duke detyruar organin e prokurorisë të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke arsyetuar se duhet të ushtrohet ndjekja penale për veprën penale “\*\*\*\*\*”, si dhe të kryhen një sërë veprimesh hetimore.

Mbi bazën e vendimit nr.\*\* datë \*\*.\*\*.20\*\* të Gjykatës së Apelit \*\*\*\*\* , në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, \*\*\*\*\* , është regjistruar procedimi penal me nr.\*\*\*\*, datë \*\*.\*\*.\*\*\*\* për veprën penale “\*\*\*\*\*”. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, më datë \*\*.\*\*.20\*\* prokurorja \*\*\*\*\* i është drejtuar Gjykatës së Rrethit, \*\*\*\*\* me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr.\*\*\*\* të vitit 20\*\*. Me Vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.\*\*.20\*\* Gjykata e Rrethit \*\*\*\*\* ka vendosur *mospranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e çështjes penale nr.\*\*\*\*, viti 20\*\* kthimin e akteve* dhe vazhdimin e hetimeve sipas detyrave të përcaktuara në vendimin gjyqësor, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit \*\*\*\*\* , me vendimin nr.\*\*\* datë \*\*.\*\*.20\*\*.

Në datën \*\*.\*\*.20\*\*, për shkak të caktimit të përkohshëm në Prokurorinë e Apelit \*\*\*\*\* , prokurore \*\*\*\*\* , është zëvendësuar në procedimin penal nr.\*\*\*\* të vitit 20\*\* me prokurore \*\*\*\*\*.

Prokurore \*\*\*\*\* , pas përfundimit të detyrave të lëna nga gjykata, në datën \*\*.\*\*.20\*\* ka përpiluar kërkesën, drejtuar Gjykatës së Rrethit \*\*\*\*\* , për pushimin e procedimit penal nr.\*\*\*\* të vitit 20\*\*, duke arsyetuar se nuk rezulton të jenë konsumuar elementët e veprës penale “\*\*\*\*\*”, apo elementët e ndonjë vepre tjetër penale. Pa kryer veprime të tjera procedurale, pasi kanë kaluar 6 muaj e 25 ditë nga përpilimi i kërkesës, në datën \*\*.\*\*.20\*\*, ka dorëzuar aktet në sekretari dhe pasi janë nënshkruar nga drejtuesi i prokurorisë shkresat përkatëse, kjo kërkesë i është dërguar Gjykatës së Rrethit \*\*\*\*\* dhe njëkohësisht me këtë kërkesë janë njoftuar edhe trashëgimtarët e viktimës.

Në datën \*\*.\*\*.20\*\*, prokurore \*\*\*\*\* \*\*\*\*\*, për shkak të pretendimeve të trashëgimtarëve të viktimës ndaj saj mbi hetimin e çështjes dhe keq interpretimeve të bëra nga media, mbështetur në nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale, ka hequr dorë nga procedimi penal nr. \*\*\*\* i vitit 20\*\*. Drejtuesi i Prokurorisë, \*\*\*\*\*, po në këtë datë, ka pranuar heqjen dorë dhe ka zëvendësuar prokurore \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* me prokuror \*\*\*\* \*\*\*\*\* në procedimin penal nr. \*\*\*\* të vitit 20\*\*.

Pas këtij zëvendësimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \*\*\*\*\*, është përfaqësuar nga prokuror \*\*\*\* \*\*\*\* në seancat gjyqësore me objekt : Pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* viti 20\*\*, për veprën penale të “\*\*\*\*\* \*\*\*\*\*” parashikuar nga neni \*\*\* i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit \*\*\*\*\*, me Vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.\*\*.20\*\*, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit, duke arsyetuar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, të përcaktuara në pjesën arsyetuese në vendim. Lidhur me kohën e kryerjes së këtyre veprimeve, gjykata ka lënë një afat 4 mujor.

Pas ankimit të prokurorit, Gjykata e Apelit \*\*\*\*\*, me Vendimin nr. \*\* datë \*\*.\*\*.20\*\*, ka lënë në fuqi vendimi nr. \*\*\* datë \*\*.\*\*.20\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \*\*\*\*\*.

Aktualisht kjo çështje është akoma në fazë hetimi paraprak.

## II. VEPRIMET PROCEDURALE TË KËSHILLI TË LARTË TË PROKURORISË

### III. VLERËSIMET DHE KONKLuzionET E KËSHILLIT

Këshilli, pasi zhvilloi seancën dëgjimore, dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe subjekti i procedimit disiplinor, arsyeton se:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi kompetent i caktuar për shqyrtimin e kërkesave për procedimin disiplinor ndaj prokurorëve të Republikës së Shqipërisë si dhe dhënien e masave disiplinore sipas rastit. Kjo kompetencë buron nga përcaktimet e Nenit 149, pika 1 i Kushtetutës i cili përcakton se “*Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë*” dhe 149/a, germa b) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *ku sanksionohet se:*

*“1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:*

*a).....*

*b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve”*

Këto parashikime Kushtetuese gjejnë zbatim edhe në nenin 159<sup>1</sup> pika 2, të ligjit 115/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Procedurat disiplinore, duke filluar nga paraqitja e ankesës, vlerësimi i pranueshmërisë, verifikimi i saj, fillimi i hetimit disiplinor, kërkesa për procedimi disiplinor, vendimmarrja e Këshillit dhe e

---

<sup>1</sup> Neni 159 Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë(Ndryshuar me Vendimin e GJK nr. 41/ 2017 dhe Ligjin nr. 47/2019 neni 11)a).....b) *vendos masa disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;*

drejta e ankimit rregullohen nga përcaktimet e ligjit 96/2016, “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke filluar nga neni 100 e deri në nenin 159 të këtij ligji.

Gjithashtu dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë, pa asnjë dyshim, në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj prokurorëve, të cilat janë hetimi disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor, i cili do të shqyrtohet dhe vendoset vetëm nga Këshilli, si një organ vendim-marrës kolegjal.

Bazuar në këto dispozita kushtetuese dhe ligjore, Këshilli vlerëson se një masë disiplinore ndaj një prokurori duhet të jepet, gjithnjë dhe vetëm, në kuadër të një procedimi disiplinor, të filluar nga organi kompetent, dhe të shqyrtuar sipas procedurave të parashikuara në ligjin “Për Statusin”, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të parimeve të procedimit disiplinor të tilla si: parimi i ligjshmërisë, akuzës, barazisë para ligjit, prezumimit të pafajësisë, proporcionalitetit etj.

Në vlerësim të procedurës rezulton se kërkesa për procedim disiplinor, paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, shoqërohet nga raporti i hetimit disiplinor i arsyetuar, si dhe dosja hetimore e cila përbëhet nga dokumentacioni i krijuar dhe administruar gjatë hetimit disiplinor, duke vlerësuar se përmbush kushtet e pranueshmërisë që lidhen me elementet formale të saj, të përcaktuara nga neni 24, i Rregullores “Mbi funksionimin e Komisionit Disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”.

Me verifikimin e plotësisë të kushteve formale, Këshilli vendosi caktimin e datës për zhvillimin e seancës dëgjimore, pasi rezultoi se nuk ndodhej në kushtet e mbylljes së procedimit pa seancë dëgjimore sipas parashikimeve të nenit 139 të Ligjit “Për Statusin”. Shkelja disiplinore që është trajtuar në këtë procedim disiplinor lidhet me faktin se ka patur një diferencë periudhe kohore prej 6 muajsh e 25 ditë që nga dita e përfundimit të hetimeve, \*\*.\*\*.20\*\* dhe njoftimit të këtij akti, e kalimin e çështjes në gjykatë me kërkesë për pushim në datë \*\*.\*\*.20\*\*, duke qenë haptas brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit, përcaktuar nga neni 117, i ligjit “Për Statusin”.

Nuk rezulton që çështja të ketë qënë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendimi i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor, sipas parashikimeve të nenit 134, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu nuk u konstatuan shkaqe për pezullimin e procedimit disiplinor, sipas parashikimeve në nenin 145 dhe 126 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi siç u shpjegua më sipër, për kallëzimin penal të depozituar në SPAK në lidhje me veprimet e prokurores zj.\*\*\*\*\*, është vendosur mosfillimi i procedimit, vendim i cili ka mbetur i pa cënuar në të dy shkallët e gjykimit.

Subjekti i hetimit disiplinor magjistratja \*\*\*\*\* ka statusin e magjistratit dhe ushtron të njëjtën detyrë si në kohën e kryerjes së shkeljes së identifikuar në raportin hetimor edhe aktualisht, atë të prokurores pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\* dhe nuk ekzistonte rrethanë faktike apo element juridik për mbylljen e hetimit disiplinor për çështje statusi të magjistratit sipas parashikimeve të nenit 134, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Konstatohet se kërkesa për procedim disiplinor, e paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë me datë \*\*.\*\*.20\*\*, është në përfundim të hetimit disiplinor të filluar me datë \*\*.\*\*.20\*\*, pra brenda afatit 6 mujor të përcaktuar nga neni 118, pika 2, e Ligjit “Për Statusin”, i ndryshuar.

Sa i takon themelit të çështjes, shkelja disiplinore lidhet me faktin se; me datë \*\*.\*\*.20\*\*, prokurore \*\*\*\*\* është ngarkuar me ndjekjen e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 20\*\*, për shkak të caktimit të përkohshëm të prokurores së mëparshme të çështjes Znj/Z. \*\*\*\*, në Prokurorinë e Apelit \*\*\*\*\*.

Pas marrjes përsipër të detyrës, nga ana e prokurores \*\*\*\*\*, është vazhduar kryerja e veprimeve hetimore në zbatim të vendimit nr. \*\*\* sp, datë \*\*.\*\*.20\*\*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, \*\*\*\*\*.

Me përfundimin e veprimeve hetimore, prokurore \*\*\*\*\* ka vendosur me aktin e datës \*\*.\*\*.20\*\*, “Njoftimin për përfundimin e hetimeve”, bazuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, akt i cili rezultoi t’i jetë dërguar për njoftim trashëgimtarëve të viktimës dhe tre personave të tjerë, me shkresat me nr. \*\*\*\*, datë \*\*.\*\*.20\*\* dhe në po të njëjtën datë është përcjellë edhe në Gjykatë kërkesa e prokurores \*\*\*\*\*, për pushimin e procedimit penal me nr. \*\*\* të vitit 20\*\*, për veprën penale “\*\*\*\*\*” të parashikuar nga neni \*\* i Kodit Penal. Aktet sa më sipër, mbi njoftimin për përfundimin e hetimeve, datë \*\*.\*\*.20\*\* dhe i kërkesës për gjykim pa datë, janë dërguar në sekretari dhe më pas për firmë, tek drejtuesi i Prokurorisë nga prokurorja \*\*\*\*\*, në datën \*\*.\*\*.20\*\*, kohë kur rezultoi të jetë nënshkruar nga drejtuesja e prokurorisë dhe protokolluar në kryesekretari.

Para kësaj date, pra \*\*.\*\*.\*\*\*\*, ashtu siç rezultoi edhe nga vetë shpjegimet e magjistrates \*\*\*\*\* dhe të trashëgimtarëve të viktimës, nuk ka pasur një njoftim të kryer nga ana e prokurores. Nga ana e kësaj të fundit është komunikuar në rrugë verbale me mbrojtësin \*\*\*\*\* dhe trashëgimtarët e viktimës lidhur me përfundimin e hetimeve, por që gjithsesi nuk është ezauruar sipas rrugëve procedurale të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale për t’iu vënë në dispozicion akti përkatës i njoftimit, sipas parashikimeve të nenit 327 i Kodit të Procedurës Penale.

Kjo periudhë nga data e përfundimit të hetimeve sipas aktit përkatës të njoftimit dhe deri në datën e dërgimit të këtij njoftimi dhe të kërkesës për gjykim në gjykatën kompetente, ka zgjatur për një periudhë prej 6 muaj dhe 25 ditë. Gjatë kësaj periudhe rezultoi se nga ana e trashëgimtarëve të viktimës dhe mbrojtësit të tyre janë paraqitur dy herë kërkesa me shkrim për informacion mbi ecurinë e hetimit të procedimit penal, ndërsa nga ana e prokurores nuk rezultoi të ketë një përgjigje me shkrim.

Prokurore \*\*\*\*\* në shpjegimet e saj gjatë hetimit disiplinor ka pranuar mos dërgimin e kërkesës në gjykatë dhe mos dërgimin e njoftimit të përfundimit të *hetimeve shtetasve* \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* për një periudhë afro 7 (shtatë) muajore, duke arsyetuar se “*është bërë me qëllimin e vetëm për t’iu komunikuar personalisht përfundimin e hetimeve në mënyrë që prindërit të kishin çdo akses në procedim dhe të ishin të bindur se organi procedues është transparent dhe çdo veprim po kryhet në interes të zbardhjes së ngjarjes dhe në zbatim të ligjit*”.

Në parashtrimet e saj para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurore \*\*\*\*\* ka pretenduar se shkelja e konstatuar është një e metë në administrimin e procedimit penal dhe jo shkelje disiplinore sipas parashikimeve në ligjin për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Sipas saj shkeljet disiplinore kryhen vetëm me dashje dhe për rastin konkret nuk ka një parashikim ligjor për afatet e njoftimit të akteve në rastet e procedimeve penale pa autor.

Në seancën dëgjimore, subjekti i procedimit disiplinor, prokurore \*\*\*\*\*, parashitroi para Këshillit të Lartë të Prokurorisë se është përpjekur t’i japë rëndësinë që i takon çështjes e cila ka pasur ndjeshmëri të lartë qoftë publike dhe njerëzore. Gjithashtu është përpjekur të mbajë kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e viktimës dhe të jetë vetë prezent gjatë veprimeve hetimore me qëllimin e vetëm që t’i bind ata se hetimi po bëhet me qëllim zbardhjen e ngjarjes dhe që

këtyre personave t'u tregojë që drejtësia jo vetëm po bëhet por edhe duhet të duket. Gjithashtu subjekti i procedimit disiplinor solli në vëmendje të Këshillit, ngarkesën e madhe të punës që po përballojnë sot prokurorët dhe në veçanti ajo vetë, e cila gjatë gjithë kohës është e angazhuar me veprime të shumta hetimore dhe përfaqësime në gjykatë.

Megjithatë veprimet e prokurores që lidhen me vonesën e dërgimit të kërkesës për gjykim dhe dërgimin e njoftimit pas përfundimit të hetimit, vlerësohen në raport me nenin 101, pika 1, shkronja "a" të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili përcakton se; magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: *"kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë"*. Gjithashtu dhe neni 102, pika 1, shkronja "d", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar përcakton si shkelje *"vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale"*.

Ndryshe nga sa pretendon prokurori \*\*\*\*\* \*\*, nga ana e Këshillit është vlerësuar se, ashtu siç parashikon neni 101, i Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë", shkeljet disiplinore mund të kryhen me dashje ose për shkak të pakujdesisë.

Kërkesa drejtuar gjykatës për miratimin e pushimit të procedimit penal dhe njoftimi për trashëgimtarët e viktimës, janë akte procedurale në kuptim të neneve 132, 133, 134, 137, 140 dhe 327, të Kodit të Procedurës Penale. Pavarësisht se nuk ka një afat të përcaktuar ligjor për njoftimin e këtyre akteve, mbajtja për një periudhë prej afro 7 muaj, pa i vënë në lëvizje këto akte procedurale, vlerësohet si zvarritje e pajustificuar e akteve procedurale, siç parashikon neni 102, pika 1, germa d, e Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në këtë kuptim shkelja e konstatuar, të cilën e pranon edhe vetë prokurorja subjekt procedimi disiplinor, nuk është një e metë në administrimin e procedimit penal por do të konsiderohet shkelje disiplinore që ka lidhje me ushtrimin e funksionit.

Neni 327 i Kodit të Procedurës Penale, përcakton se prokurorja subjekt procedimi ka detyrimin që në rastin konkret të dërgojë çështjen në gjyq si dhe të njoftojë viktimën ose trashëgimtarët e saj sipas mënyrave të përcaktuara në nenin 137, të Kodit të Procedurës Penale.

Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se, masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, individualizmit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, si dhe duke vlerësuar se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates \*\*\*\*\* \*\*, parashikohen si shkelje, nga neni 102, pika 1, germa "d", e Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Për një vlerësim të drejtë, proporcional dhe objektiv në lidhje me këtë shkelje, janë shqyrtuar aktet e procedimit penal nr.\*\*\*\*\* të vitit 20\*\*, provat e administruara, qëndrimet e prokurorisë dhe gjykatës në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të këtij procedimi penal, pretendimet e trashëgimtarëve të viktimës, avokatit mbrojtës të tyre, parashtrimet e subjektit të procedimit disiplinor prokurori \*\*\*\*\* \*\*, ngarkesa e punës së prokurorit \*\*\*\*\* \*\* për vitin

20\*\*, informacioni i përfituar nga regjistrat e prokurorisë në lidhje me takimet e zhvilluara me trashëgimtarët e viktimës, çdo akt tjetër i nevojshëm që mund të shërbejë për të bërë një vlerësim sa më të drejtë e objektiv të kriterëve për caktimin e masës disiplinore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe provave të administruara në lidhje me procedimin penal nr.\*\*\*\* të vitit 20\*\*, rezulton se pas caktimit të përkohshëm të prokurores së çështjes \*\*\* \*\*\*\* në Prokurorinë e Apelit \*\*\*\*\*, me urdhër të Drejtueses së Prokurorisë \*\*\*\*\*, të datës \*\*.\*\*.20\*\*, Znj/Z. \*\*\*\*\* është ngarkuar me ndjekjen e procedimit penal nr.\*\*\*\* që ndodhej në fazë hetimi dhe që për të duhet të realizoheshin detyrat që kish lënë gjykata.

Pasi ka përfunduar detyrat e lëna nga gjykata për këtë procedim penal, në datën \*\*.\*\*.20\*\*, prokurore \*\*\*\*\* ka përpiluar për gjykatën kërkesën për miratimin e pushimit të procedimit penal nr.\*\*\*\* të vitit 20\*\*.

Rezulton gjithashtu se prokurorja \*\*\*\*\* me mosveprim, ka zvarritur në mënyrë të pa justifikuar aktet e procedimit penal nr.\*\*\*\* të vitit 20\*\*, pasi nga data \*\*.\*\*.20\*\*, kur është përpiluar akti dhe deri në datën \*\*.\*\*.20\*\*, kur është dërguar kërkesa për pushim në Gjykatën e Rrethit \*\*\*\*\*, procedimi penal është mbajtur pa asnjë veprim në zyrën e saj dhe pa i njoftuar trashëgimtarët e viktimës në lidhje me këtë zgjidhje ligjore, duke i hequr mundësinë gjykatës dhe trashëgimtarëve të viktimës, për të ushtruar të drejtat e tyre sipas ligjit, për një periudhë kohore prej 6 muaj e 25 ditë. Me këtë mosveprim, prokurore \*\*\*\*\* nuk ka përmbushur siç duhet detyrën e saj gjatë ushtrimit të funksionit.

Në analizë të kriterëve për caktimin e masës disiplinore, për sa i takon llojit dhe rrethanave të shkeljes së konstatuar ajo do të klasifikohet sipas parashikimeve në nenin 102, pika 1, germa d, të Ligjit nr.96/2016, i ndryshuar, ku parashikohet: “zvarritje të pa justifikuara të akteve procedurale”

Në kryerjen e kësaj shkelje kanë ndikuar disa rrethana:

- *Së pari*, përvoja e shkurtër profesionale e magjistrates \*\*\*\*\*. Fakti që ajo ushtron funksionin e prokurorit prej dy vjetësh, pa një përvojë të konsoliduar për çështje me impakt të dukshëm në publik, ka qenë një nga rrethanat që kanë ndikuar drejtpërdrejt në shkeljen e kryer.
- *Së dyti*, raportet e krijuara me trashëgimtarët e viktimës dhe kontradiktat që prokurorja ka patur me ta në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes ka qenë një nga rrethanat që ka ndikuar në kryerjen e kësaj shkelje.
- *Së treti*, ngarkesa e punës që aktualisht po përballojnë prokurorët për shkak të proceseve që shoqërojnë reformën në drejtësi dhe veçanërisht ngarkesa e punës që ka përballuar prokurore \*\*\*\*\* për vitin 20\*\*, e/i cili ka pasur në ndjekje gjithsej 381 çështje, prej të cilave ka evaduar 237 çështje, është një rrethanë tjetër që ka ndikuar në kryerjen e shkeljes.
- *Së katërti*, transmetimi në media, në lidhje me procedimin penal nr.\*\*\*\* të vitit 20\*\* dhe komentet negative në këtë emision në lidhje me punën e prokurores, ka qenë një rrethanë tjetër që indirekt ka ndikuar në kryerjen e shkeljes.

Përsa i takon shkallës së fajësisë dhe motivit, nga provat e administruara ka rezultuar se shkelja është kryer me neglizhencë e mosveprim. Nuk provohet që prokurore \*\*\*\*\* të ketë patur një motiv të saj për të kryer shkeljen. Në qëndrimin e saj gjatë hetimit disiplinor dhe atë para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurorja \*\*\*\*\* ka pretenduar se zvarritja ka ardhur për shkakun e vetëm se është përpjekur gjatë gjithë kohës që të ketë kontakte personale me trashëgimtarët e viktimës dhe t'i bind ata për kryerjen e veprimeve hetimore dhe se hetimi po bëhet me qëllim zbardhjen e ngjarjes. Synimi ishte që drejtësia jo vetëm të bëhej po dhe të dukej. Ky fakt provohet me shpjegimet e trashëgimtarëve të viktimës, mbrojtësit të trashëgimtarëve të



viktimës, këqyrjen së librit të hyrje-daljeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë \*\*\*\*\* dhe regjistrimet në media.

Pretendimet e trashëgimtarëve të viktimës se zvarritjet janë kryer me dashje për shkak të daljes së tyre në media, nuk qëndrojnë.

Mosveprimi i prokurores, nuk mund të lidhet me transmetimin në media, pasi për herë të parë në lidhje me këtë çështje emisioni “\*\*\*\*\*” është transmetuar në TV \*\*\*\*\* më datën \*\*.\*\*.20\*\*. Referuar kësaj date, kishin kaluar 3 muaj nga data kur prokurorja kishte përpiluar kërkesën për gjykatë për pushimin e procedimit penal nr.\*\*\*\*\* të vitit 20\*\* dhe akoma nuk kishte dërguar aktet në gjykatë dhe nuk i kishte komunikuar trashëgimtarëve të viktimës mbylljen e hetimeve. Ky fakt rrëzon pretendimin e trashëgimtarëve të viktimës se zvarritja ka ardhur për shkak të transmetimit të rastit në media.

Përsa i takon pasojave të shkeljes, duhet thënë se shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 1, germa d, e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk kërkon domosdoshmërisht ardhjen e një pasoje.

Për të bërë një analizë të pasojave të ardhura nga shkelja, duhet ti referohemi qëndrimit që ka mbajtur gjykata në lidhje me kërkesën e prokurores \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* për miratimin e pushimit të procedimit penal nr.\*\*\*\*\* të vitit 20\*\*, dhe detyrave që ka lënë gjykata për plotësimin e hetimeve të këtij procedimi penal. Referuar detyrave që ka lënë gjykata, zvarritja në tërësi e hetimeve dhe zvarritja e pa justifikuar e kryer nga prokurore \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , vë në vështirësi kryerjen e disa prej veprimeve hetimore të lëna nga gjykata dhe në pamundësi kryerje të ndonjë veprimi tjetër hetimor. Sigurisht që kjo zvarritje ndikon drejtpërdrejt edhe në humbjen e besimit të publikut tek prokuroria dhe vetë prokurorja.

Sa i takon magjistrates \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , duhet thënë se është diplomuar si jurist me datë \*\*.\*\*.20\*\*, është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin e dytë me \*\*\* pikë dhe është radhitur e pesta nga magjistratët e diplomuar në vitin akademik \*\*\*\*\*-\*\*\*\*\*. Për aftësitë profesionale është vlerësuar “shumë mirë”

Është certifikuar si avokat në datën \*\*.\*\*.20\*\* dhe ka përfutur trajnime të ndryshme të organizuara nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës, me Vendim nr. \*\*\* datë \*\*.\*\*.20\*\* të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Znj/Z. \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* është emëruar prokurore dhe është caktuar me detyrë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, \*\*\*\*\*.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se për vitin 20\*\*, prokurore \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , ka përballuar një volum të madh pune në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë \*\*\*\*\* dhe ka qenë korrekte në ushtrimin e funksionit si prokurore.

a) Sa i takon rrethanave lehtësuese dhe rënduese në lidhje me shkeljen, si rrethanë lehtësuese duhet mbajtur parasysh fakti se shkelja kryhet për herë të parë dhe se në kryerjen e shkelje kanë ndikuar edhe palët e treta.

Duke pasur parasysh se procedimi penal nr.\*\*\*\*\*/20\*\*, në dy raste të mëparshme është kthyer për plotësim hetimi nga gjykata, shkelja e kryer ka pasur ndikim të vogël në rezultatet e hetimit të çështjes. Në rastin konkret nuk evidentohen rrethana rënduese për shkeljen e kryer.

e) Në tërësinë e rrethanave dhe fakteve të mësipërme, shkelja e kryer nga prokurore \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , vlerësohet të jetë e lehtë dhe masa disiplinore ndaj kësaj prokuroreje duhet të jepet për shkelje të lehtë. Për shkelje të lehta ligjvënësi ka parashikuar si masa disiplinore në bazë të nenit 106 dhe nenit 107 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “*vërejtje konfidenciale*” dhe “*vërejtje publike*”. Në rastin konkret, duke patur parasysh parashikimin e pikës 3, të nenit 106, të këtij ligji, për vërejtjet konfidenciale, ku

thuhet “Vërejtje konfidenciale jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes”, kjo masë disiplinore nuk mund të aplikohet për prokuroren \*\*\*\*\* , pasi rasti është bërë publik nga media. Masa disiplinore e aplikueshme për rastin mbetet “vërejtje publike” e parashikuar nga neni 107, i Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se, masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, individualizimit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, si dhe duke vlerësuar se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates \*\*\*\*\* , parashikohen si shkelje, nga neni 102, pika 1, germa “d”, e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

## **KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 184, shkronja “e” dhe neni 189, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, neni 192 paragrafi 1 fjalia e dytë, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; nenet 101, germa “a”, 102, germa “d”, neni 107 dhe 146 pika 2 germa “b”, dhe neni 149 pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i ndryshuar; nenin 104 të Kodit të Procedurës Administrative së Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedimin disiplinor nr.\*\*\*\*\* prot., datë \*\*.\*\*.20\*\* ndaj prokurore Znj/Z. \*\*\*\*\* .
2. Dhënien e masës disiplinore “Vërejtje publike”, për prokurore Znj/Z. \*\*\*\*\* , me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Znj/Z. \*\*\*\*\* brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë sipas ligjit dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

## **KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR**  
**GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR**  
**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**  
**KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR**  
**BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**  
**NURIHAN SEITI**

**ANËTAR**  
**ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR**  
**ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR**  
**MOISI DUDA**

**ANËTAR**  
**VATË STAKAJ**

**ANËTAR**  
**SANDËR BECI**

**ANËTAR**  
**TARTAR BAZAJ**